




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12 par. 12.1, dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 14,19,20,21 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233, Vendimit të MMPH / AMMK Nr.7518/18 të datës 19.12.2018, Raportin për propozimin e shpalljes zonë e mbrojtur natyrore nga grupi punues 7036/19 datë 04.12.2019 neneve 9 dhe 20 par 20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 14.12.2020, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

VENDIM
PËR SHPALLJEN E LOKALITETIT TË BOSHTRËS (FORSYTHIA EUROPEA)
GOLESH SI ZONË E MBROJTUR

Neni 1

MIRATOHET, Vendimi për shpalljen e lokalitetit të Boshtres "Forsythia Europea" – Golesh si zonë e mbrojtur në kategorinë e monumentit të natyrës.

Neni 2

Zona e mbrojtur si monument i natyrës që e përfshinë territorin e Komunës së Lipjanit është në sipërfaqe prej prej 33.2 Ha.

Boshtra " Forsythia Europea" kategorizohet në kategorinë e monumentit të mbrojtur të natyrës për ruajtjen e arealit të kësaj bime të rrallë.

Neni 3

Sipërfaqja e zonës së mbrojtur e evidentuar në nenin 2 të vendimit të cilës i caktohen dhe vendosen kufijtë për territorin e mbrojtur përfshin lokacionin cili shtrihet në parcelat kadastrale: P-71409016-00213-0 ZK Vrellë –Pronë e Kuvendit Komunal, Parcela P-71409016-00214-0 ZK Vrellë –Pronë Private Zeka Topalli, Parcela P-71409016-00215-0 ZK Vrellë – Pronë Private Sylejman Topalli, Bekim Topalli, Agim Topalli, Parcela P-71409016-00217-0 ZK Vrellë – Pronë Private -Syl Kelmendi, Parcela P-71409016-00215-0 ZK Vrellë – Pronë Private -Islam Topalli, Parcela P-71409016-00219-0 ZK Vrellë – Pronë Private –Ismet Dugolli, Parcela P-71409016-00220-1 ZK Vrellë – Pronë Shoqërore Seksioneve të pylltarisë

Neni 4

Masat për mbrojtje që duhet të ndërmerren konform legjislacionit në fuqi në zonën e cekur janë:

- 1.1 Mos ndërtimi i objekteve të pa planifikuara,
- 1.2 Vazhdimi i hulumtimeve të mëtejme të vlerave natyrore,
- 1.3 Ndalimi i hedhjes së mbeturinave.
- 1.4 Ndalimi i prerjes së drunjëve pa leje të posaçme të Sektorit të pyllatrisë.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtorati për Shërbime Publike dhe Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Neni 6

Ky vendim pas hyrjes në fuqi, duhet të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe i dërgohet Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit dhe Institutit Kombëtar për Mbrojtjen e Monumenteve me qëllim të regjistrimit në Regjistrin e vlerave të mbrojtura të natyrës.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

15 Nr. 463 - 60412

Lipjan, më 14.12.. 2020

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

